



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranimi / Doretoria Prilpimo / Prodato Received / Delivery		15.06.2022 viti god year	
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot. No. Prot. Prot. No.	Shënim Billog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPKSH/3516/2022			1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.439/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.439/2022 të datës 05.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, respektivisht kundër organit të punësimit/Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.439/2022 e datës 05.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtuese i Mesëm, i Ulët dhe Profesional i datës 20.04.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, sipas Akt emërimit të datës 27.05.2019, është në pozitën "Zyrtar Ligjor për Shqyrtimin e Dokumenteve të Shitjes" të cilit me datë 27.01.2022 Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Kryesuesi i Njësisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor dhe Tenderimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ia ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 me të cilin ankuesin e vlerëson me notën e përgjithshme jo kënaqshëm ose jo mjaftueshëm 1.12.



Ankuesi, kundër vlerësimit të rezultateve të punë për vitin 2021, ka shprehur mos pajtimin lidhur me vlerësimin e rezultateve punës që i është bërë dhe ka kërkuar nga Udhëheqësi i tij respektivisht Kryesuesi i Njësisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor dhe Tenderimit që të bëjë rishqyrtimin e performancës për vitin 2021 dhe kërkon nga Udhëheqësi që të ketë takim.

Departamenti i Burimeve Njerëzore me datë 28.02.2022 përmes e-mail-it zyrtarë është vënë në dijeni për mos pranim të vlerësimit të performancës nga ana e zyrtarit me ç' rast nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka kërkuar rivlerësim të performancës dhe se Departamenti i Burimeve Njerëzore ka bërë përpjekje që t'i ftojë të dy palët në takim me datë 04.02.2022 lidhur me komunikimin dhe mos pajtimin për vlerësim të performancës ndërsa në takim ka qenë vetëm mbikëqyrësi i ankuesit e ankuesi nuk ka qenë në takim pasi që nuk e ka marrë njoftimin me kohë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me datë 21.03.2022 merr vendimin me numër A.nr.112/2022 me të cilin vendim anulohet vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 27.01.2022 për ankuesin si dhe është obliguar Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Kryesuesi i Njësisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtim Ligjor dhe Tenderimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit ligjor për pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimiit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit pas pranimiit të Vendimit A.nr.112/2022 të datës 21.03.2022, ka bërë zbatimin e vendimit të Këshillit kështu duke e rivlerësuar ankuesin me notë të përgjithshme 4.2.

Ankuesi i pa kënaqur me rivlerësimin përfundimtarë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë për vitin 2021 me datë 05.05.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2608/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 05.05.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; e-mail i datës 12.04.2022, 12.04.2022, 15.04.2022, 20.04.2022; Formulari i vlerësimit i datës 20.04.2022; Ankesën e ankuesit të datës 10.02.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtuese i mesëm, i ulët dhe profesional (për periudhën Janar - Dhjetor 2021); E-mail i datës 03.02.2022, 02.02.2022, 31.01.2022, 28.01.2022, 04.02.2022; Akt Emërimi i ankuesit; Përshkrimi i punës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës si dhe Prova shtesë nga organi i punësimit i datës 14.06.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit se është i pa kënaqur me rivlerësimin përfundimtarë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë

për vitin 2021 si dhe ka theksuar se me rastin e rivlerësimit Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ka shtuar komente shtesë në pikën 1.5 tek fusha e Komunikimit dhe Përfaqësimit. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshme sepse në bazë të provave të lëndës është konstatuar se rivlerësimi i ankuesit është bërë në pajtim me Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, respektivisht në pajtim me nenin 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 ku përcaktohet se „*Vlerësimi i rezultateve në punë - nënkupton një proces të përhershëm që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit i cili realizohet në pajtim me nenin 43 dhe 71 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë si dhe në pajtim me këtë Rregullore*”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar se rivlerësimi i datës 20.04.2022 për rezultatet e punës për ankuesen për periudhën janar - dhjetor 2021, është bërë pozitiv e që është në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 dhe paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: *“1. Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: 1.4. nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton “shumë mirë” si dhe 2. Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: 2.2. “shumë mirë”, vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit”, dhe në rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka pas parasysh edhe faktin se vlerësimi përfshin arritjen e objektivave për ankuesin në bazë të detyrave të punës dhe se për objektivat ankuesi nuk është vlerësuar jo për fajin e tij por se Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin me Nr.02/15 të datës 23.03.2020 dhe të Vendimit me Nr.07/09 të datës 01.07.2020 ka pezulluar të gjitha valët e shitjes, ku në bazë të provave edhe vlerësuesi ka komentuar se objektivat për vitin 2021 nuk kanë mund të realizohen për shkak situatës me COVID-19 dhe Vendimeve të Qeverisë andaj Kolegji ka konstatuar se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi dhe prova të mjaftueshme me të cilat do të dëshmonte se rivlerësimi i rezultateve të punës për periudhën janar-dhjetor 2021 ka qenë jo objektiv dhe i pa drejtë.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se në bazë të provave të lëndës është vërtetuar se ankuesi është rivlerësuar drejtë lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, sepse nota e përgjithshme pas rivlerësimit është në pajtim me komentet, dhe rrjedhimisht në rastin konkret udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit pas rivlerësimit ka respektuar dispozitat e nenit 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 paragrafit të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të Kryetares së Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.439/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.